



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 7-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 30.06.2026, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Murat Gërbeshi, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Armend Grajçevci, anëtar
6. Venhar Agushi, anëtar
7. Gentianë Hoxhaj - Gashi, anëtare
8. Elmaze Behluli, anëtare
9. Shefki Bytyqi, anëtar
10. Sanije Mehmeti, anëtare
11. Anila Reçica- Llugiqi, anëtare
12. Gentrin Sylaj, anëtar
13. Besim Jusufi, anëtar
14. Arsim Jashari, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Liridon Hajrizi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Egzona Gashi, anëtare
19. Xhenetë Isufi- Mollopolci , anëtare
20. Yllëza Bedrolli, anëtare
21. Fatmir Fetahu, anëtar
22. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
23. Arjeta Statovci- Tasholli, anëtare

Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
2. Mehreme Goliqi, nënkryetare për komunitete
3. Latif Ramadani, DBF
4. Shkelzen Hajdini, DSHMS
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Safete Amerllahu, DGJK
7. Imri Semetishti, DUPMM
8. Astrit Buja , DKRS
9. Ajkuna Maliqi, DA
10. Rexhep Rexhepi, DBPZHR
11. Rasim Hasani, DKA
12. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi në vazhdim rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 6-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025.
3. Propozim Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2024 dhe 2025 në vitin 2026.
4. Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizes Afatmesme Buxhetore 2027-2029.
5. Propozim Rregullore për taksat dhe gjobat komunale.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2026-2030.
7. Propozim Vendim për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit Nr.320/01-26973 i datës 16.06.2026.
9. Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan.
10. Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Vëllëzrit Frashëri” në Lipjan.
11. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Pastrimi”.

12. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan, për Vendimin paraparak 15NR.463/02-17208 i datës 29.03.2024 dhe Vendimin NR.15-462/01-22762 të datës 08.05.2024 për korrigjimin e Vendimit paraparak.
13. Propozim Vendim për anulimin e Vendimit paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonën Kadastrale Lipjan 15NR.462/01-20084 të datës 30.04.2026.

Para se më hodhë në votim rendin e ditës i uroj përzgjedhjen drejtorit të ri Astrit Buja ne DKRS, duke i uruar suksese dhe punë të mbarë.

Pastaj pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Pastaj e hodhi në votim rendin e ditës me ndryshmet dhe pikat shtesë dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 27 vota për, aprovoi propozimin.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtareve të Kuvendit.

Gentrit Sylja, tha se duke u bazuar nga kërkesat e qytetarëve kërkojë nga komuna se bashku me institucionet kompetente të shqyrtoj mundësinë e ndalimit ose kufizimit të qarkullimit të trotinetëve dhe skuterëve elektronik në sheshin e qytetit. Pasi që qarkullimi i këtyre po paraqet rrezik për sigurinë publike në veçanti për fëmijët dhe të moshuarit andaj kërkojë nga organet kompetente të ndërmarrin masa dhe të ketë një hapësirë me të sigurtë për qytetarët.

Arsim Jashari, tha se pari i kam disa pyetje për drejtorin e Urbanizmit a ka mundësi me na sjellë shkresën e ministrisë se çka ka lyp për planin zhvillimor, pasi që keni thënë që e keni një shkresë dhe ne antaret e kuvendit po duam me pa atë shkresë. Pyetja e dytë se ka informacione që i keni bërë disa ndryshime të planit zhvillimor komunal pa i pruar fare në kuvend a është e vërtetë kjo? Nëse ka diçka duhet me na njoftuar neve anëtarëve të kuvendit. Pyetja për drejtorin e shëndetësisë si ka mundësi më qene anëtarë e komisionit vartësja e udhëheqëses e cila është nën urdhërat e saj. Te komisioni për shtëpinë baze të komuniteteve. Pyetja tjetër në shtëpinë bazë për komunitete një paciente me probleme psikikë e ka vjedhur çelësin e derës dhe në ora 03:00 të mëngjesit ka dal dhe infermierja ka qenë fjetë në atë kohë, ndërsa pacientja vjen deri të pompa e derivateve të "Sach Pica" dhe askush nuk reagon për këtë. Për nënkryetarin një pyetje, ik drejtori hajde gruaja, ik gruaja hajde drejtori a është në rregull kjo punë, drejtori po ep dorëheqje po i pranohet në pune gruaja e tij. A e ka dhënë dorëheqje para se me ju punësu gruaja apo pasi ju ka punësuar gruaja ka dhënë dorëheqje.

Egzona Gashi, tha se kam për ti ngritur disa kërkesa të qytetarëve, e para banorët e fshatit Krojmir pyesin kur do të bëhet zgjerimi i urave nga "Marshi i UÇK-

së e tjetra të “Gryka e Shpëtimit”. Kërkesa tjetër është nga qytetarët e fshatit Sllovi dhe Gadime për mirëmbajtje të trotuareve pasi që paraqet një rrezik të madh për qytetarët. Ndërsa banorët e rrugës “Zylfije Gashi” vazhdojnë të përballen me vështirësi të mëdha për shkak të gjendjes së keqe të rrugës dhe deri tani nuk kemi parë ndonjë investim në atë rrugë edhe pse gjendja në atë rrugë çdo ditë e me shumë po keqësohet dhe po rendohet.

Xhentë Isufi, tha se kam dy kërkesa e para nga qytetarët për rregullimin e rrethojës të shtegu i ecjes dhe pastrimi i lumit pasi që po është rrezik për qytetarët të cilët po e vizitojnë atë vend. Kërkesa e dytë është nga qytetarët e “Lagjes së Doktorëve” të rruga “Haxhi Kleçka” për vendosjen e policëve të shtirë pasi që qarkullimi i veturave po bëhet me shpejtësi të pa kontrolluar.

Argjend Tasholli, tha se edhe unë i kam për ti ngritur disa kërkesa të qytetarëve e para ka të bëjë me kanalet e ujit apo vërshimet që po ndodhin në disa lokalitete si në Gadime dhe fshatra tjera. A keni ndërmarr diçka që këto kanale të rihapen. Kam një kërkesë, në Gadime e kemi një festë “Mërgata Fest” që e organizojmë që nëntë vite por mendoj që këtë herë duhet, kam kërkesë që ju ekzekutivi ta organizoni ju një ‘Mërgata Fest’ siç i ka hije, pasi që po ka probleme me financat.

Arjeta Statovci Tasholli, tha se e kam një kërkesë të qytetarëve të fshatit Poturoc të cilët janë të shqetësuar për mos mbledhje të mbeturinave. Dy mbledhje më parë kryeari ka marrë guxim politik për të rritur në kuvend taksat e mbeturinave ndërsa që disa javë ato mbeturina nuk mblidhen fare në territorin e komunës së Lipjanit. Pyetja e dytë ka të bëjë me qytetarët e fshatit Kraishtë për rregullimin e trotuarit pse është ndërprerë punën afër shkollës. Pse nuk është bërë prej fillimit të fshatit rregullimi i trotuarit.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se çështja e parë që do ta ngrisë ka të bëjë me raportin e auditorit i cili ka gjetë një seri shkeljesh në menaxhimin e mjeteve dhe punëve nga komuna siç janë keq klasifikimi i shpenzimeve miliona euro, pagesat në kundërshtim me kontratat, vonesat në pagesa të faturave të obligimeve, mungesa e monitorimit të subvencioneve dhe pranimi i serave pas përfundimit të kontratës e shumë gjetje tjera. Pyetja ime është pse nuk është sjell në kuvend sot raporti i auditorit. Tjetra në këtë muaj komuna ka mbajtur një akademi përkujtimore për Dëshmoret e Komunës së Lipjanit dhe ne nuk jemi ftuar se paku nga një përfaqësues i partive tjera. Dhe aspak nuk është e pranueshme dhe ferr të interpretohet të familjet e dëshmorëve se nuk kemi dashur të marrim pjesë. Unë e sqaroj që ne nuk kemi marrë ftesë për mbledhje, se ma e pakte që do të mundet të bënim ne është të merrim pjesë në këtë mbledhje për familjet e dëshmorëve. Një reagim tjetër në faqen e komunës ka dalë në diskutim rregullorja për menaxhimin e parkingjeve në Lipjan, por jo edhe në faqen zyrtare në facebook. Ndërsa pjesëmarrja në bazë të njoftimit në facebook ka qenë me e

vogël. Një shqetësim tjetër është mos mbledhja e mbeturinave që disa jave çka o tu ndodh me këtë a mund të na jep një sqarim dikush.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se sa i përket raportit të auditorit, unë se kam sjell në kuvend për shkak të numrit të madh të pikave që i kemi pas për këtë mbledhje. Ndërsa mbledhjen e ardhshme do ta keni raportin e auditorit për diskutim në kuvend.

Dimant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se çështja e trotineteve në sheshin në i kemi vendos tabelat që janë të ndaluar dhe kjo është në kompetencë të policisë. Rasti në shtëpinë komuniteteve ka ndodh, por është neutralizuar si rast dhe ska ndodh diçka më shumë. Sa i përket konkursit bashkëshortja e tina ka aplikuar dhe drejtori ka dhënë dorëheqje morale. Asfaltim i rrugicave në Lipjan shumë shpejt do të filloj duke e përfshirë edhe atë rrugën “Zylfije Gashi”. Parku të lumi “Sitnica” po mirëmbahet, por ka nevojë të zgjerohet lumi por në fazat tjera do të ketë edhe rrethoja të lumit. Policët e shtrirë aty kanë qenë të vendosur sepse ajo rruga është mjaftë e frekuentuar. DKR-ja është duke i bërë përgatitjet për “Mërgata Festën” në qytetin e Lipjanit të cilin e bënë tash e disa vite. Por mund të ndihmojmë me një kërkesë për mbështetje financiare për Gadime. Sa i përket mbeturinave ne jemi duke i marr dy kamion më qira për kompaninë pastrimi për shkak të gjendjes me mbeturina për me shtua nevojat e kompanisë dhe me e rrit numrin e punëtorëve në sezonë për shkak të gjendjes së kompanisë. Trotuari në Kraishtë, në disa vende është ndërpre për shkak që nuk ka pasë hapësirë në pronë publike. Ftesa për akademi përkujtimore ka qenë e publikune në faqe të komunës kush ka dashtë ka marrë pjesë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha sa i përket dëgjimit publik të rregullores për parkingjet është e publikuar edhe në faqen publike në facebook të komunës me datë 08.06.2026 dhe ju kisha lut mos dezinformoni.

Imri Semetishti, tha se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal në fund të vitit 2023 është lidh një kontratë, merr miratimin dhe tani jemi në fazën kur është hartua edhe raporti për zhvillimin strategjik mjedisor lidhur me PZHK-në. Këtë raport para se me shku në debat publik në vitin 2023 është shkuar në Ministri e Mjedisit për aprovimin e këtij raporti ministria e ka trajtuar më vonesë dhe në vitin 2024 na ka kthye email ku nuk mundeni me votuar sepse nuk është trajtuar deponia sanitare të zona e Kërqevës. Dhe aty kemi has në pengës dhe nuk kemi mundur të vazhdojmë me tutje. Që nga ai vit nuk e kemi pasur asnjë aktivitet lidhur me hartimin e PZHK-se. Dosjen e kemi dhe mund ta ketë kushdo nga anëtarët e kuvendit. Pyetja e dytë lidhur me ndryshimet në PZHK nga fillimi i këtij viti kemi filluar angazhimet për përditësimin e dokumentit paraprak të PZHK-se. Arsyeja kryesore ka qendër regjistrimi i fundit e të dhënave demokratike të cilat kanë ndryshuar nga vitin 2011 dhe duhet të ndryshohen tani. A e kemi trajtuar në PZHK, jo ende se kemi marr pëlqimin pastaj del në kuvend dhe ju do ta keni si draft në shqyrtim publik.

Ne dokumentin e tanishëm jemi bazuar në vendimin e qeverisë për depononi regionale në Kërqevë. PZHK nuk miratohet nga Drejtoria Për Urbanizëm por nga kuvendi.

Shkelzen Hajdini, tha se ishin dy pyetje për shëndetësi për pyetje e parë nuk e di sa i përket shefit por i pyes zyrën e personelit ju njoftoj. Ndërsa sa i përket shtëpisë për komunitete po ka ndodh ju tregoi edhe nënkryetari. Aty është vështirë të menaxhohen për shkak të rasteve të ndjeshme mund të ndodhin gabime dhe ka ndodh një gabim dhe ne do të përgjigjemi.

Imri Semetishti, tha se sa mi dërgoj të dhënat menaxherja e kontratës në vitin 2013 e kemi dërguar në ministri në vitin 2024, ministria i ka kërkuar disa ndryshim plotësime pastaj ato plotësime i kemi dërguar në komisionin e ministries dhe nuk kemi marr asnjë përgjigje për refuzimin e kërkesës tonë.

Arsim Jashari, tha kam vetëm dy pyetje, janë datat dhe duhet me i respektuar të gjithë dhe vitin e kaluar neve na ka ardh emaili nga sektori i kuvendit ndërsa këtë vit hiç. Po ashtu vitet e kaluara ka pas vend ku ulen dhe shefat e grupeve ndërsa këtë vit jo. Është mirë herët tjera me pas organizim ma të mirë dhe me pas diskutim edhe shefat e grupeve sepse dëshmorët janë të të gjithëve. Kam një pyetje për nënkryetarin dje e keni mbajtur KKSB-në, e kam një shqetësim nga qytetarët e Grackës ku disa të rijnë në fshatin Grackë ku po vijnë me autobusë dhe po i provokojnë qytetarët. A e keni diskutuar këtë temë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha një sqarim nuk ka qenë seance solemne e kuvendit, por akademi përkujtimore për ditën e dëshmorëve.

Argjent Tasholli, tha se kërkesa që e pata për mërgata festë nuk është qëllimi jonë që me na lëshuar komuna mjete financiare, qëllimi jonë është që ai organizmi që bëhet që nëntë vite e meriton mbështetjen e DKRS dhe komunës, kërkohej që ju ta menaxhoni sepse po është problem me ja dal vetëm me financa. Një organizim që e meriton mbështetjen tuaj.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ne e kemi një vendim në kuvend për organizimin e një festivali në qytetin e Lipjanit ‘Mërgata Fest’

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se çështja e ftesës u sqarua. Ne kemi qenë të kujdesshëm dhe do të jemi prap dhe këtë do ta merr Sektori i Kuvendit herët tjera pasi që drejtorive po ju ikin. Çështja e fshatit Grackë nuk e kemi diskutuar dhe nuk e kemi ditë për këtë rast, ndërsa për rastin në Magurë është diskutuar. I cili rast tani ka kaluar në Prokurori Speciale dhe gjykatë. “Mërgata festë” mund ta zgjerojmë ne të ardhëm edhe në lokalitete me të mëdha.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën e parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 6-të.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 24 vota për, aprovoi ekstraktet nga mbledhja e 6-të e kuvendit.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

II

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoj të pranishmit me të dhënat nga Propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Armend Grajqevci, tha se rritja e të hyrave vetanake mbi 700 mije euro tregon një menaxhim të jashtëzakonshëm të financave komunale për përmirësim të arkëtimit të të hyrave. Kjo hyrje tregon që komuna mundet me mbështet më shumë projekte pa u mbështet në grantin qeveritar dhe këto mjete janë planifikuar në fushat që kanë ndikim të drejtpërdrejt në nevojat e qytetareve. Ku shumica e këtyre mjeteve do të shkoj në investime kapliate duke realizuar shumë projekte infrastrukturore, shëndetësore dhe pjesa për shërbime komunale. Kjo është një tregues pozitiv pas probleme financiare nga vendimet përmbarimore nga kontrata kolektive. Ne grupi i LDK-se, e mbështesim këtë propozim.

Argjend Tasholli, tha se është mirë aty ku merret borxhi të kthehet, buxheti është rritë mbi 700 mije euro dhe keni parapare disa projekte por asnjë nuk është kthyer ne Gadime. Për vitin 2026 projektet që i ka pas Gadimja edhe ato ja marrë njeri 170 mije euro tjetri mi 70 mije. Çka keni planifikuar ju tani për fshatin Gadime me rrethinë kur tani janë vetëm 50 mije euro për Gadime . A e meritonin këtë Gadimja?

Arsim Jashari, tha se është mire me ja sqaruar qytetarëve që për qendrën multifunksionale qendrën e kulturës që nuk ju ka ndryshuar emri, por e ka ashtu siç e ka pas Qendra Kulturore “Tahir Sinani” dhe emri i saj nuk preketë. Ne si grup do ta mbështesim këtë propozim vendim.

Alban Salihu, tha se zakonisht kemi thënë që te kjo pikë ka rritje për shkak të keq planifikimit të buxhetit të realizim të buxhetit. Krahاسimi duhet të bëhet me vitin e kaluar dhe duhet të dihet siç është bërë rritja për shkak të rritjes së çmimit apo rritjes së shërbimeve. Këtu është një gabim teknik ku thuhet se totali është mbi 3 milion, e ne realitet rritja është mbi 700 mijë euro dhe jo mbi 3 milion.

Latif Ramadani, tha se unë thash kam kënaqësi kur kam kësi pika në kuvend që flitet për menaxhim dhe rritje. Totali i rritjes është 700 mije euro. Kjo shumë do të mundësoj me i realizuar projektet ku na ka marr përmbaruesi mjetet.

Alban Salihu, tha unë s’do të insistoj me i përmirësuar gabimet, por totali i rritjes o mbi 700 mijë jo mbi 3 milion euro.

Argjent Tasholli, tha se unë thash të rritja e buxhetit është planifikuar diku tjetër dhe nuk janë kthyer mjetet aty që janë marr në Gadime.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me një gabim teknik që do të përmirësohet dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 21 vota për,3 abstenime aprovoi propozimin.

III

Propozim Vendim mbi dhënjen e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2024 dhe 2025 në vitin 2026.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arjeta Statovci Tasholli, tha se sa i përket Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2024 dhe 2025 në vitin 2026, çdo bartje mjeteve si pasuri e pa shpenzuar publike e cila nuk shpenzohet me kohë e humb vlerën si rikapitalizim i vlerës. Duke pas parasysh nevojat e qytetarëve punët e pa kryera të ekzekutivit pasojat do ti bartin qytetarët.

Aremdn Grajqevci, tha ne grupi i LDK-se, e mbështesim propozim vendim mbi dhënjën e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2024 dhe 2025 në vitin 2026 mbi të gjitha mendojmë që ky vendim është i ndarë proporcionalisht në projekte të ndryshme.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 13 vota për, 7 kundër 4 abstenime aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizes Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi.

Armedn Grajqevci, tha se sot para vetes e kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Me këtë shihet vizioni ynë institucional për zhvillimin e komunë së Lipjanit për vitet që vijnë. Fillimisht kam një propozim që në këtë buxhet që në bazë të mundësive financiare të shtohen dhe dy kamion për mbledhjen e mbeturinave për shkak të gjendjes së renduar në teren. Pasi që mendoj që edhe ju keni pranuar ankesa gjatë kësaj kohe. Po ashtu në kuadër të mundësive të punësohen dhe disa punëtor sezonal për shkak të gjendjes emergjente me mbeturina. Ky buxhet është gjithë përfshirës në çdo aspekt dhe meriton mbështetje e të gjithëve. Në grupi i LDK-se e mbështesim këtë propozim vendim pasi që është vazhdimësi e punës së mire.

Argjent Tasholli, tha se në grupi i PDK-se, do të jemi kundër jemi këtij propozim vendimi. Unë e kam bërë disa krahasime të buxhetit të vitin 2025 dhe 2026, në lokalitetin nga vij, ku janë lyp vota me një planifikim mbi 2 milion euro, ndërsa pas zgjedhjeve në KAB janë vetëm 1 milion euro. Për këtë arsye në nuk do të votojmë sepse nuk keni realizuara asgjë me atë që keni premtuar.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se fillimisht i kam dy vërejtje ,e para për kryetarin që nuk merr pjesë në mbledhje. Vërejtja tjetër ka të bëjë si ka mundësi që neve me na ardh drafti për vitet 2027-2029 ndërsa dëgjimet buxhetore të caktohen pastaj kjo i bijën që buxhetin e keni planifikuar vet dhe në kemi ardh në dëgjime kot. Sot qytetaret e Lipjanit përballën me ujë të pijes kanalizim dhe kjo është shqetësuese

e te cilat nuk janë prioritet dhe zgjidhje e këtij ekzekutivi. Ne jemi për zhvillim të komunës së Lipjanit dhe për prioritate e nevojshëm të qytetarëve e jo për projekte që shtohen nga një vit në vitin tjetër.

Arsim Jashari, tha prej vitin 2021 disa propozime të mijat janë shty nga një vit në vitin tjetër dhe ende nuk janë realizuar dhe si pritni që të votojmë një buxhet kur propozimet tona nuk merën parasysh, shkolla Banullës, trotuari çerdhja dhe shumë projekte tjera.

Alban Salihu, tha se nuk pajtohem me mënyrën e ju të shpenzoni të hyrat dhe ne e kemi humb besimin që ju i merri propozimet tona, unë vazhdimisht kam marr pjesë në dëgjime publike buxhetore dhe asnjëherë nuk janë marr parasysh. Nëse e shikon buxhetin shumica janë rikonstruktimi i rrugëve dhe projekteve dhe këtë që e kemi kritikuar ne që projektet po behën shkel e shko tash po shihet që projekte e përfunduara po investohen prapë në to. Na në vend me investuar në projekte të reja po duhet me u marr me projektet që janë kryer keq.

Liridon Hajrizi, tha se unë e kam një pyetje rreth ndërtimit të lumit në fshatin Hallaq i Vogël pasi që sipas informatave ky projekt është heq nga buxheti. Pse është heq nga buxheti ky projekt.

Latif Ramadani, tha se unë thash ky është vetëm kornize dhe kjo ka kohë deri në Shtator atë që e kemi premtuar në do ta realizojmë. Sa i përket dëgjimeve buxhetore ju e keni obligim me qenë në dëgjime buxhetore dhe me i dhënë propozimet tuaja. Sa i përket lumenjve është një vendim nga ministrja Pacolli që mos të ndërtohen me beton.

Alban Salihu, tha të ndërtimi i stacionet të autobusëve a është për këtë aktualin.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se po bëhet fjale për stacionin e autobusëve aktualin ku të gjitha procedurat ligjore janë përfunduar.

Argjent Tasholli, tha se unë u mera me krahasime nga viti i kaluar nëse nuk janë reale dil kundërshtoj. Vetëm 50 mijë euro janë për Gadime që do të realizohen e mbi 1 milion janë premtuar.

Nexhmedin Lekiqi, tha se edhe unë pajtohen që uji i pijes kanalizim të jenë prioritet. Sa i përket buxhetit duhet të planifikohet dhe të realizohet e jo vetëm të ëndërrohet.

Latif Ramadani, tha se premtimet janë për katër vite dhe ne do ti realizojmë brenda këtij mandati. Vendimet përmbartimore na kanë shkaktuar probleme. Te restaurimi i rrugëve do të vazhdohen disa rrugë që janë ndërtuar në vitet 2024 e tutje e të cilat do të zgjerohen.

Shahadije Bikliqi, tha se me ligjin për vetëqeverisje lokale infrastrukturë është përgjegjësi e komunës dhe duhet komuna me rregulluar ujësjellësin. Ju si komunë duhet me u takuar më ujësjellësin dhe me gjetë zgjidhje për ujë të pijes.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se për fshatin Babush ka thënë ujësjellësi me investuar një gyp për ujë të pijes ne kemi investuar dhe që një vit prapë nuk ka ujë të pijes. Na po investojnë por prapë ujë s'po ka.

Feriz Hasnai, tha deri me sa po e shoh problemi kryesor janë mbeturinat, pasi që ligji s'po lejon komuna me marr një kompani të paktën me rrit çmimin për pagesë të mbeturinave dhe të shtohen edhe disa kamion për kompaninë pastrimi dhe të rritet dhe numri i punëtorëve. Dhe të bëhet një zgjidhje për çështje e pastrimit.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ligjërisht nuk kemi me marr kompani private për mbeturina që disa vite kemi themeluar ndërmarrjen publike dhe asgjë ende nga ministria nuk na është kthyer. Ne kemi investuar në blerje të kontejnerëve, në furnizim me derivate por prapë gjendja është e njëjtë.

Alban Salihu, tha se kryetari i komunës ka ardh në pushet duke premtuar ujë të pijes 24 ore. Dhe si ndiheni që katër mandate në pushet dhe skeni arrit mi realizuar gjerat më elementare.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ne ndihemi shume mirë pasi që kemi realizuar të gjitha ato që kemi premtuar. E dyta tani qytetarët e kuptojnë se cila është kompetence e jona e cila e nivelit qendror.

Valon Pacolli, tha ne prej vitit 2021 kërkojmë themelimin ndërmarrjes publike Ulpiana dhe nga ai vit skemë marr asnjë përgjigje si Lipjan ndërsa komunat tjera si Shtime, Fushë Kosovë, Kamenicë i kanë themeluar këto ndërmarrje dhe kjo bëhet politikisht.

Alban Salihu, tha se nëse merret shembull Fushë Kosova ajo është edhe më keq sa i përket gjendjes me mbeturina. Dhe sa do te jeni ju të sigurt që kjo ndërmarrje do ta zgjidhte këtë problem. Dhe një kryetar që udhëheq që trembdhjetë vite nuk ish dashtë me lanë guri pa lëvizë që këto problemet më elementare të zgjidhen.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit jeni në qeverisje që pesë vite dhe asnjë investim të ri nuk e keni pruar në Lipjan

Valon Pacolli, tha se ti si anëtar i kuvendit duhet me e ngrit në nivel qëndror çështjen e ndërmarrjes lokale pasi që i përket asaj partie. Ju ftoj kushdo prej anëtarëve të kuvendit të vie te unë në zyrë dhe ti shikoj shkresat dhe emailat që ja kemi dërguar ministrisë për ndërmarrjen publike.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 15 vota për, 12 kundër, aprovoi propozimin

Pastaj Kryesuesi dhe pauze nga ora 12:00 deri në ora 13:30

V

Propozim Rregullore për taksat dhe gjobat komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit më të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se ne e kemi mbështet këtë rregullore, por është mire me ditë pse është tërheq kjo rregullore për qytetaret, me ju tregu që ka pas mangësi ka pas probleme por ne si grup do ta mbështesim këtë rregullore.

Arjeta Statovci-Tasholli, tha se sa i përket kësaj rregullore unë do të ndalëm të neni 9 i kësaj rregullore të taksat për objektet lëvizëse në sipërfaqet publike, shuma në këto taksa vlera duhet të jetë sa me të ulëta dhe të pranueshme për xhepin e qytetarëve, ndërsa aty ku janë të rrezikuar profesionet të lirohen nga taksat. Ndërsa te neni 10 është një emërtim shfrytëzimi i sallave dhe kinemave çka është kjo takse, dhe të neni 17 te 100 euro një korsi e 200 euro dy korsi.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se herën e kaluar kur ka ardh kjo rregullore në kuvend ka qanë e përfshirë edhe taksa për parkingje, ndërsa tani është hequr. Pse është hequr taksa për parkingjet.

Armend Graçjevc, tha për mes kësaj rregullore komuna krijon të hyra vetenake dhe këto çmime janë esenciale. Ne grupi i LDK-se, e përkrahim këtë rregullore.

Argjent Tasholli, tha se edhe unë do te ndalem të neni i 9 te taksat për objektet lëvizëse, të pika 8 automjetet me lëvizje të shpejtë çka nënkuptojnë këto. Dhe çmimi me duket shumë i ulët pse ky çmim. Pasi që ne Lipjan kemi shume lokale që merren me përgatitjen e ushqimit të shpejtë dhe qiraja është shumë e larte. Këtë mjetet lëvizëse do ti dëmtojnë bizneset ekzistuese të gastronomisë. Një pyetje të neni 14 taksat për antena të telefonisë mobile dhe internetit a keni paraparë ndonjë takës si shtetet tjera që kompanitë më shfrytëzuar pronën komunale.

Valon Pacolli, tha se sa i përket rregullores unë po përgjigjem në mënyre të përgjithshme, rregullorja ka kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe këto propozimet kanë mujt me ardhë në dëgjim publik. Çështja e tërheqjes së rregullores është kërkuar nga grupi i LDK-se, mbledhjen e kaluar dhe tani prite të jetë një rregullore e veçantë vetëm për parkingjet.

Arjeta Statovci-Tasholli, tha se deri sa është propozim vendim ne mund ti jepim propozimet tona për ndryshim, e nëse skeni paraparë me i marr parasysh propozimet tona nuk është ne rregull.

Arsim Jashari, tha se a jeni te sigurt që rregullorja për parkingje do ta kaloje ligjshmërie në ministrinë përkatëse. Për arsye se që kjo rregullore i cakton taksat dhe sa jemi të sigurt që kalon ajo do të ishte mire me qenë në këtë rregullore edhe taksat për parkingje.

Shahadije Bikliqi, -Dragaçina, tha se shpesh po na kritikoni që nuk po marrim pjesë në dëgjime publike, por edhe pse marrim si merrni parasysh propozimet tona. Ne kemi mundësi edhe ne kuvend me propozuar ndryshime por as këtu s'po merren për bazë. Te rregullorja për parkingje a do të ketë taksa në bazë të saj apo kësaj rregullore.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ajo rregullore kur te vjen do të bazohet në këtë rregullore dhe disa taksa janë të rregulluara me ligj ne nuk mund ti ndryshojmë.

Valon Pacolli, ne kemi të drejtë me pas edhe rregullore për parkingje dhe është bërë një punë e madhe.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 20 vota për, 3 abstenime, aprovoi propozimin

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2026-2030.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit drejtor i DSHPMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se ne e mbështesim këtë propozim vendim, por kam dy çështje për ti ngritur, e para tani çmimi i derivateve ka ra ndërsa çmimi i biletave nuk bie fare. E dyta problemi ma i madh, momentin që po përfundon procesi mësimorë ato lindja nuk po vazhdojnë. Është mirë inspektorati me u marr me këto çështje.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se ne këtë plan operatorët që i marrin vijat a jeni të sigurt që ju përmbahen vijat kur dihet që shpesh herë nuk shkojnë me i marr udhëtarët sidomos në Teqe.

Burim Rustemi, tha çmimi i biletave me vend, mirëpo ne nuk mund ta caktojmë çmimin pasi që kompanitë e caktojnë vet çmimin. A respektohen linjat e kanë për obligim me i respektuar dhe ne jemi përgjegjës për respektimin e këtyre linjave se bashku me drejtoratin e inspektoratit.

Hyra Bytyqi, tha se a ka mundësi që orari i qarkullimit të autobusëve të vendoset edhe në stacionet pritëse të autobusëve në qytet dhe fshatra. Po ashtu të shikohet mundësi se bashku me kompanitë e autobusëve që pensionistët të kenë udhëtimin pa pagesë.

Burim Rustemi, tha oraret do të vendoset në stacionin bazë në Lipjan ndërsa për pensionistët nëse kemi buxhet pse mos ua mundësuar pensionistëve pa pagese.

Feriz Hasani, tha se është mirë aty ku ka me pak njerëz që linjat e autobusëve të subvencionoj komuna sikur janë në disa vende të Evropës, por nuk e di sa kemi ne mundësi ta bëjë ne këtë.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit drejtor i DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit më të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se është bërë një punë shumë e madhe ku e falënderoj komisionin e kaluar dhe këtë komision për punën e bërë. Janë disa kritere ku duhet të vendoset një emër e jo secili do vendos emrin e babës apo gjyshit të vet. Po me pëlqen edhe lista e pritjes që e ka lënë ky komision me emra rezerëve dhe ne do ta mbështesim.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se në këtë propozim vendim e pash që vetëm një rrugë e re është e emërtuar në Janjevë ndërsa sipas banorëve kanë pas edhe kërkesa tjera njëra nga stacioni policor deri të ura e shkollës dhe tjetra rruga ekzistuese që është “Sarai” deri të shkolla. Çka ka ndodh me këto dy propozime që nuk janë marr parasysh, njëra ka pas me u vendos “Afrim Berisha” dhe tjetra “Irfan Bikliqi”.

Alban Salihu, tha se fillimisht unë do të votoj për këtë dokumenti sepse anëtarët tonë kanë votuar për. Por s’po muj pa kritikuar se shumë shpesh po mundohet të bëhet një luftë në mes të familjeve se kush po e vendos emrin e familjareve të vet. Unë po e votoj edhe për një arsye sepse po shoh këtu shumë emra të bukur si “Alpet Shqiptare” “ Rreze Goleshi” dhe unë isha shkuar me emra të bukur shqip. Dhe anëtarët e komisionit tonë kanë votuar për.

Nexhemdin Lekiqi, se ne si komision kemi bërë një punë të madhe e cila ska qenë edhe e lehtë, dhe unë nuk kisha vendos asnjë emër të përveçëm dhe shumica prej tyre janë emra shqip të bukur që kemi vendas si komision.

Argjent Tasholli, ne banoret e fshatit Gadime kemi pas një kërkesë për emërtimin e një rruge që është gjithëpërfshirës “Rruga e Xhamisë” të bëhet një ndare të rrugët “6 maji” dhe “ Ibush Tasholli”. Kjo ka qenë një kërkesë e arsyeshme besoj dhe nuk është marr parasysh unë do të votoj kundër.

Nexhmedin Lekiqi, tha se unë propozim e parë e kam dhënë për atë rrugë pasi që unë jam rritë tu i thënë të rruga e Xhamisë, por nëse e shikon rregulloren ajo lagje nuk i ka 10 familje, vullneti u kanë pro nuk na është lejuar të bëhet ajo.

Imri Semetishti, tha se korniza ligjore ka parapare disa kritere si’ nen 10 shtëpi s’mund të këtë emër, kriteri i dytë gjatësia e rrugës, kriteri i tretë emrat ekzistues nuk mund të përdoret. Dhe kemi pas shumë kërkesa të tilla që nuk i kanë plotësuar këto

kritere siç është rasti i Gadimes të rasti Tasholli dhe në Janjevë për dy emrat. Na jemi në hall me adresë të regjistrimit të adresave që ende nuk i kanë regjistruar as 60% të qytetarëve. Ne mund të kemi lëshuar ndonjë gabim apo lëshim, por jemi munduar të bëjmë me të mirën e mundshme.

Feriz Hasani, tha se komisioni ka bërë një punë shumë të mirë, dhe për dallim prej viteve më herët që janë vendosur emrat ka qenë shumica prona private dhe shumica kanë lyp emra të familjarëve ndërsa tani janë avancuar gjerat .

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me një ndryshim të vogël ku duhet të përmirësohet të bëhet përballe xhamisë , ndërsa është përballë shkollës në Banullë, dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 23 vota për,2 kundër aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit Nr.320/01-26973 i datës 16.06.2026.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtor DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Armend Grajqevci, me qëllim të evitimit të konfliktit të interesit për shkak që përfitoni një familjar i imi unë nuk do të marr pjesë në votim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha nëse edhe dikush ka konflikt interes mos të voton.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 24 vota për aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjinnazi “Ulpiana” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se propozimi i parë na ka ardh në mars ne e kemi përkrah i dyti në prill ka ardh ju kam thanë po presim s'po veprojnë nuk është marr parasysh propozimi jonë. Dhe na kane humbur gati gjashtë muaj është mire me i përcjell këto propozime më herët e jo me na u kthyer çdo propozim. Ne si grup do të votojmë kundër.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha pasi që bëhet fjale vetëm për ndryshimit e titullarit në grupi i LVV-së do ta mbështesim këtë propozim.

Rasim Hasani, tha se vendimi ka qenë gjithçka në rregull dhe na me harta zonale jemi krejt në rregull vetëm e kemi ndarë vetëm titullarin e shkollës. Gjatë diskutimeve më ministrinë kane thënë në rregull janë po prapë e kanë kthyer rishqyrtim.

Arsim Jashari, tha se nëse e dini qe keni të drejte shfrytëzoni procedurën ankimore në gjykatë.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 16 vota për, 8 kundër, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët "Vëllëzrit Frashëri" në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin

Meqë diskutime nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 15 vota për, 8 kundër 1 abstenim, aprovoi propozimin

XI

Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi".

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqi nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se këtu tash është pika ku duhet më diskutuar për kompaninë pastrimi, aksionaret e Lipjanit kanë dhënë kontributin e tyre po si ka marr për baze askush. Gjendja me mbeturina është shumë e keqe dhe duhet të shpallet gjendje e jashtëzakonshme e mbeturinave sot unë e pash të tregu gjendja ke tmerruese. Është mirë komuna me ju qel rrugë komunave që me e formuar një ndërmarrje komunale dhe me bërë zgjidhje qytetarëve. E dyta kompania Pastrimi duhet me dal me një njoftim në faqe zyrtare me thanë këtë javë nuk dalim me i mbledh mbeturinat mos i qitni mbeturinat jashtë. Si grup këtë propozim e mbështesim por duhet të bëhet një zgjidhje sa ju përket mbeturinave sepse gjendja është emergjente.

Shahadije Bikliqi-Dragaçna, tha propozimin për anëtarë kemi abstenuar ne votim edhe për këtë do te abstenojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 22 vota për, 3 abstenime, aprovoi propozimin.

XII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan, për Vendimin paraparak 15NR.463/02-17208 i datës 29.03.2024 dhe Vendimin NR.15-462/01-22762 të datës 08.05.2024 për korrigjimin e Vendimit paraparak.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, drejtor i DPUMMI cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Gentiane Hoxhaj tha se për anëtar te komisionit nga radhët e LDK-se, e propozojmë Fitim Shala.

Arsim Jashari, tha nga grupi i PDK-se, për anëtar të komisionit e propozojm Besim Jusufi.

Kryesuesi i kuvendit tha se përbërja e komisionit është si vijon :

1. Imri Semetishti nga ekzekutivi i komunës,
2. Latif Ramadani nga ekzekutivi i komunës,
3. Fitim Shala, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK,
4. Besim Jusufi, anëtar i kuvendit nga subjekti politik PDK dhe
5. Bekim Krasniqi, nga sektori joqeveritar lokal.

Meqë diskutime tjera nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 22 vota për, 2 abstenime, aprovoi propozimin.

XIII

Propozim Vendim për anulimin e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonën Kadastrale Lipjan 15NR.462/01-20084 të datës 30.04.2026

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se kuvendi me 21 vota për, 2 abstenime , aprovoi propozimin.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14:55.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Zyrtari Ligjor

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi